



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KRYESIA E KËSHILLIT BASHKIAK MALLAKASTËR

VENDIM

Nr. 852 prot

Ballsh më 20/02 / 2026

Nr. 02 datë 20 / 02 / 2026

“Për miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës”

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 17, 56 dhe 57, dhe në mbështetje të Rregullores së Funkcionimit të Këshillit Bashkiak, miratuar me VKB Nr.12 datë 24.02.2020, Neni 22, Kryesia e Këshillit në mbledhjen e datës 20 / 02 / 2026;

Vendosi:

1. Miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak, e cila do të mbahet më datë 26/02 / 2026.
2. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes sipas dokumentit bashkëlidhur ketij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për dërgimin e njoftimit dhe rendit të ditës, si dhe materialet relevante për mbledhjen tek secili këshilltar, tek kryetari i bashkisë, deputetët e qarkut dhe personat apo organizatat që kanë bërë kërkesë, si dhe me përgatitjen e dosjes së mbledhjes dhe dërgimin e dosjes së mbledhjes tek secili këshilltar dhe tek kryetari i bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

1 - Anëtari i Kryesisë së Këshillit

(\_\_\_\_\_)

1 - Anëtari i Kryesisë së Këshillit

*(Guzana Malaj Malaj)*

Kryetari i Këshillit Bashkiak

*(Meduni Selaj)*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI BASHKIAK MALLAKASTËR

Nr. 852 / prot.

Ballsh më 2002 .2026

**Lënda:** Njoftim për zhvillimin e mbledhjes së radhës të Këshillit të Bashkisë Mallakastër.

**- ANËTARËVE TË KËSHILLIT BASHKIAK MALLAKASTËR**

**Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË MALLAKASTËR**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar, neni 53 pika 4, neni 56 pika 2, shkronja “a”, në mbështetje të Rregullores së Funkcionimit të Këshillit Bashkiak, dhe mbledhjes së mbajtur nga kryesia e këshillit, njoftoheni se mbledhja e radhës e Këshillit të Bashkisë Mallakastër do të mbahet në Sallën e Mbledhjeve të Këshillit pranë Bashkisë ditën Enjte, datë 26.02.2026, ora 14:00, me këtë rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes më datë 29.01.2026.
3. **Projektvendim Nr.09:** Për miratimin e listës për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike me fondin deri në 6%.  
**Komisioni për shqyrtim: Komisioni Juridik.**
4. **Projektvendim Nr.10:** Për miratimin e raportit të performancës së Këshillit Bashkiak Mallakastër për vitin 2025.  
**Komisioni për shqyrtim: Komisioni Juridik.**
5. **Projektvendim Nr.12:** Për miratimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor Të Rinisë si dhe mënyrës së organizimit dhe funksionimit të tij.  
**Komisioni për shqyrtim: Komisioni Juridik.**
6. **Projektvendim Nr.11:** Për një ndryshim në VKB Nr.50, datë 23.12.2025 “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Mallakastër, institucioneve në varësi, funksioneve të transferuara dhe deleguara për vitin 2026, të ndryshuar..  
**Komisioni për shqyrtim: Komisioni i Ekonomisë.**

KRYETAR KËSHILLI

Nexhmi Sulaj

